



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 9 Prot.

Tiranë, më 06 / 01 / 2020

V E N D I M

Nr. 3, Datë 06 / 01 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.89 Regj., datë 29.07.2019, të K. L, kundër Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, K. L, rezulton se ai ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Gjirokastër nga data 01.08.2010 deri në datën 15.8.2018, datë në të cilën i është dhënë masa disiplinore “Largim nga puna”.

Rezulton e provuar se, në fillim të marrëdhënieve të punës me DRSSH Gjirokastër ankuesi ka punuar në detyrën e Specialistit të Kontrollit të Pagesave në Degën e Financës. Me Urdhërin me nr.1610 prot., datë 14.06.2018 K. L është transferuar në Degën e Kontributeve në pozicionin e Specialistit të Vetëpunësuar në Bujqësi, pozicion të cilin ai e ka pranuar, meqenëse nuk i cënohej elementi pagë.

¹ Subjekti ankues provon anëtarësinë e tij në forcën politike të subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë.

²Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Me Urdhërin me nr.2149 prot., datë 31.07.2018 subjekti ankues është komanduar për një periudhë 3 mujore në pozicionin e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër. Subjekti ankues nuk e ka pranuar këtë pozicion për shkak se atij jo vetëm i ka ndryshuar pozicioni i punës por edhe elementi pagë, pasi ky pozicion ka pagë më të ulët. Ai e ka kundërshtuar atë pranë DRSSH Gjirokastër duke kërkuar sqarime lidhur me motivin e ndryshimit të pozicionit të punës. Në mungesë të një përgjigjeje zyrtare, tre ditë pas këtij komandimi, ankuesi ka vënë në dijeni DRSSH Gjirokastër dhe DSSH nëpërmjet e-mailit se nuk ishte dakord me këtë urdhër.

DRSSH Gjirokastër, nëpërmjet shkresës me nr.2226 prot., datë 08.08.2018, ka urdhëruar kalimin në një detyrë të një kategorie më të ulët për një periudhë një vjeçare, me motivacionin për “Mosparaqitje në punë për pesë ditë rresht”. Në vijim, me Urdhërin me nr.1262 prot., datë 15.08.2018 DRSSH Gjirokastër ka marrë masë disiplinore me “Largim nga puna” për ankuesin me motivacionin “Për mosparaqitje në punë për 12 ditë rresht”.

Z.L pretendon se transferimet e tij përveçse të paligjshme, janë edhe tendencioze dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike, të ndryshme nga ato të titullarit të Insitucionit. Ai ka cituar se sjellja diskriminuese ndaj tij ka vijuar pas ndërrimit të Drejtorit të DRSSH Gjirokastër.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit, për shkak të bindjeve politike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

³Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr.1174/1 prot., datë 01.08.2019 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues DRSSH Gjirokastrë, lidhur me pretendimin e ankuesit.
- Nëpërmjet shkresës me nr. prot.1976/1, datë 06.08.2019, DRSSH Gjirokastrë ka informuar Komisionerin se:
 - As Institucioni, as titullari i tij, nuk kanë asnjë informacion apo të dhënë rreth bindjeve politike të ankuesit, pasi në asnjë rast ai nuk i ka evidentuar ato.
 - Në asnjë rast në Insitucion nuk është folur dhe as vepruar mbi bindje politike, por vetëm bazuar në kërkesat e meritokracisë, interesit e realizimit të detyrave dhe të zbatimit të ligjit.
 - Pasi janë njohur me pretendimin e ankuesit, Institucioni është interesuar dhe ka mësuar se ai nuk është pjesë e asnjë strukture politike dhe as i zgjedhur, prandaj ata pretendojnë se ky pretendim i tij është spekulativ dhe keqdashës.

DRSSH Gjirokastrë citon se: *“Në Institucionin tonë është i punësuar aktualisht, një nga pinjollët e familjes L, A. L”.*

Në funksion të sqarimit të qëndrimit të tij, institucioni i DRSSH Gjirokastrë, ka parashtruar sa më poshtë citohet:

- *“K. L ka filluar punë në DRSSH Gjirokastrë me datë 01.10.2010, në pozicione të ndryshme dhe në dy vitet e fundit ka punuar në Degën e Financës si Specialist i Kontrollit të Pagave, ndonëse arsimi i tij nuk i përgjigjej vendit të punës dhe ishte në kundërshtim me kriteret e vendosura nga ISSH dhe Ministria e Ekonomisë. Specialiteti i tij ishte për Administrim Publik.*
- *Pas problematikave të hasura gjatë fillim vitit 2018 në Degën e Kontributeve, Degë që ka për objektiv mbledhjen e të ardhurave, kërkesës për ritëm të lartë në realizimin e Planit dhe Objektivave të ISSH, DRSSH Gjirokastrë nisi të bëjë riorganizimet e duhura për të realizuar detyrat e ngarkuara nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë.*
- *K. L, me arsim Administrim Publik e emëruam në detyrën paralele me detyrën e mëparshme, në pozicionin e Koordinatorit të Vetëpunësuar në Bujqësi dhe z.J.Z me eksperiencë mbi 35 vjeçare në pozicionin e Kryetarit të Degës së Kontributeve. Ky ishte një moment kur nisi dhe mospranimi dhe kundërshtimet e z.L.*

- *Ish-Kryetaren e Degës së Kontributeve, znj.A.M, me arsimim Ekonomiste e Lartë, dega Kontabilitet-Financë, e ulim në detyrë pas dorëheqjes nga ky post për shkak të rezultateve të dobëta e ngarkesës së madhe, e emëruam Specialiste të Pagave në Degën e Financave, pozicion ku kishte punuar më parë.*
- *Pas këtyre lëvizjeve, si pasojë e eksperiencës dhe riorganizimit të punës nga z.J.Z si Kryetar Dege erdhën dhe rezultatet e para, situata nisi të ndryshojë disi dhe u rrit numri i kontribuesve që derdhën detyrimet. I gjithë stafi i DRSSH Gjirokastër nisi të punonjë non stop, madje edhe punonjësit e tjerë të DRSSH të shtunë e të dielë i mobilizua që të shkonin në zonat e tyre në ndihmë të Degës së Kontributeve. Organizuam dhe punën promovionale, takimet në njësi administrative, takimet në fshatra, me mediat e deri me rrjetet sociale për derdhjen e kontributeve.*
- *Ecuria në Degën e Kontributeve që u bë dhe prioritet i DRSSH për realizimin e të ardhurave, nisi të përmirësohej ndjeshëm duke dhënë frytet e veta, (nga 35-50% u rritëm në 60-78%). Në fund të muajit Korrik në tre zona të mëdha rurale që mbuloheshin nga tre inspektorë na u krijuan probleme, pasi njëra prej inspektoreve A.P mori lejen e lindjes, tjetra V.M u largua nga DRSSH ndërsa inspektorja G.Xh ndodhej e shtruar në Spitalin Rajonal Gjirokastër. Të ndodhur në këto kushte e vështirësi të mëdha për realizimin e të ardhurave, Drejtori i DRSSH në bazë të Rregullores së ISSH detyrohet të komandojë për një afat 3 mujor K. L, veç detyrës së tij si Inspektor Bujku në Njësinë Administrative Lunxhëri për shkak dhe të eksperiencës së fituar në detyrën e Inspektorit të Bujkut në një zonë të pambuluar. Ky komandim është kryer bazuar në Rregulloren nr.32, datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH”, sipas Kreut I, rekrutim e komandim i përkohshëm në detyrë, pika 2 “Komandim i përkohshëm në detyrë” dhe pika 2/1 për nevojat emergjente, për plotësimin e menjëhershëm të vendit të punës, Inspektor Bujku në ALSSH Gjirokastër. Pas periudhës 3 mujore të komandimit z.L do të rikthehej në pozicionin e mëparshëm, detyrë, të cilën ankuesi e refuzoi në mënyrë kategorike dhe prej kësaj kohe nisi kundërvënia, sjellja jokorrekte me punën dhe kolegët, mospajtimi dhe mungesa e plotë e bashkëpunimit. Prej kësaj kohe, me qëndrimet e tij të hapura ai nisi të ushtrojë presion mbi punonjësit dhe të sabotojë realizimin e detyrave. Disa ditë pas marrjes së detyrës Koordinator i të Vetëpunësuarve në Bujqësi, z.L u propozua nga Dega e Administrimit të DRSSH për anëtar të KRA të DRSSH në bazë të Rregullores së ISSH. U thirr nga drejtori i DRSSH dhe jo vetëm që nuk pranoi të merrte këtë detyrë, por në prani të juristit dhe kryetarit të KRA, z.A.M dhe pjesëmarrësve të tjerë reagoi në mënyrë krejt të papërshtatshme, pa etikë dhe më një sjellje thellësisht të padenjë për një punonjës administrate. Për këtë veprim e sjellje të tij, nga ana e drejtorit të DRSSH në datën 28.06.2018, ju dha masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”.*
- *Në datë 31.07.2018, z.L është komanduar në detyrën e Inspektorit të Bujkut, në prani të kryetarit të Degës së Kontributeve, z.J.Z, Përgjegjëses së ALSSH Gjirokastër dhe kryetarit të Degës së Administrimit. Sërisht, z.L me një sjellje krejtësisht të padenjë e refuzoi këtë detyrë, nuk e pranoi duke kundërshtuar në mënyrë demonstrative para të gjithë punonjësve të DRSSH duke u sjellë negativisht, duke mos dorëzuar detyrën dhe duke mos u paraqitur asnjë ditë në punë.*

- Përgjegjësja e ALSSH znj. V.K ku ankuesi duhej të paraqitej për të marrë detyrën si i komanduar, na njofton me shkresë zyrtare se z.L për 5 (pesë) ditë me radhë nuk u paraqit në detyrë duke refuzuar zbatimin e urdhërit, duke ushtruar presion tek punonjësit e tjerë duke na krijuar vështirësi të mëdha në realizimin e detyrës. Në këto kushte, i kam rekomanduar Komisionit të Disiplinës përmes një relacioni të marrë në shqyrtim veprimet e tij dhe të vendosë masën disiplinore “Kalim në një kategori të një klase më të ulët, për një vit”, sipas Rregullores.
- Kryetari i Komisionit të Disiplinës (KD), z.A.M i ka bërë njoftimin për thirrje në Komision, por ai ka refuzuar të firmosë, madje ka ushtruar presion dhe kërcënim të llojit: “E kemi personale bashkë”.
- Me datë 07.08.2018 është mbledhur KD dhe në mënyrë unanime propozuan masën disiplinore “Kalim në një kategori të një klase më të ulët deri në një vit”.
- Me datë 08.08.2018, Drejtori i DRSSH Gjirokastër ka firmosur urdhërin për marrjen e masës “Kalim në një kategori të një klase më të ulët deri në një vit”.
- Po me këtë datë, z.L është thirrur nga kryetari i Degës së Administrimit z.I.GJ dhe i është bërë thirrje për reflektim dhe për marrjen e detyrës por sërish, z.L ka refuzuar. Në të njëjtën ditë është thirrur dhe nga Drejtori i DRSSH Gjirokastër dhe i është komunikuar se dhënia e masës nuk është qëllim në vetvehte dhe se me punë dhe përkushtim ajo shlyhet, duke i bërë thirrje për reflektim dhe fillimin e punës, por z.L ka refuzuar. Për këtë problematikë është vënë në dijeni dhe Drejtori i Përgjithshëm, z.A.H si dhe Drejtorja e Administrimit të Përgjithshëm.
- Pas 11 ditëve që ankuesi nuk ishte paraqitur në detyrë dhe krijimit të problematikës së krijuar për realizimin e të ardhurave, në bazë të informacionit me shkrim të përgjegjësës së ALSSH Gjirokastër, znj.V.K me datë 14.08.2018, DRSSH Gjirokastër i ka rekomanduar KD të mblidhet dhe të shqyrtojë veprimet arrogante dhe sjelljen e Inspektorit të Bujkut, K. L, si dhe shkeljet e kryera prej tij, në bazë të Rregullores së ISSH dhe Kodit të Punës.
- Sërish, kryetari i KD, z. A.M ka njoftuar për t’u paraqitur në KD ankuesin por ai ka refuzuar të firmosë.
- Me datë 15.08.2018 është mbledhur KD i DRSSH për të shqyrtuar situatën dhe veprimet e Inspektorit të Bujkut, K. L, ku pas diskutimeve me votë unanime i ka rekomanduar drejtorit të DRSSH për z.L, masën disiplinore: “Largim nga puna”. Z.L ka refuzuar të merrte pjesë në mbledhjen e KD.
- Menjëherë pas këtij rekomandimi, drejtori i DRSSH Gjirokastër ka nxjerrë urdhërin e largimit nga puna të Inspektorit të Bujkut, K. L.
- Në konkluzion të gjithë sa mësipër, vlerësojmë se largimi nga puna i K. L është kryer për shkak të thyerjes së rëndë të Rregullores së ISSH, Kodit të Punës dhe të etikës, si dhe për pengim me dashje të realizimit të detyrave e objektivave të DRSSH Gjirokastër. DRSSH Gjirokastër ka zbatuar Vendimin e KD që vendosi unanimisht largimin nga puna të ankuesit”.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së K. L, Komisioneri me datë 29.10.2019⁴ realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit me autorizim⁵ të DRSSH Gjirokastrës, z.A. M.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe u ra dakord që secila nga palët që ka dokumentacion, prova apo parashtrime të reja lidhur me pretendimet e tyre, t'i depozitojë pranë KMD-së në vijim.

3. Me datë 01.11.2019, subjekti ankues nëpërmjet e-mailit personal⁶ ka dërguar pranë KMD-së, në cilësi prove foto të ndryshme nëpërmjet të cilave ankuesi provon pjesëmarrjen e Drejtorit të DRSSH Gjirokastrës, z.O. K, në aktivitetet politike të Partisë Socialiste të Gjirokastrës. Fotot janë të publikuara në faqen zyrtare të Partisë Socialiste Gjirokastrës, dhe z.O. K, shihet të jetë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme, gjatë fushatës zgjedhore të Qershorit të vitit 2017, në krah të Kryetarit të Partisë Socialiste Gjirokastrës, z.B. K dhe Kryetarit aktual të Bashkisë Gjirokastrës, z.F. G.

Ndërkaq, theksojmë se nga ana e DRSSH Gjirokastrës nuk u sollën parashtrime apo dokumentacion shtesë, në mbështetje të pretendimit të tyre se ankuesi nuk ishte diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, sikundër u citua gjatë seancës dëgjimore nga ana e përfaqësuesit të këtij institucioni.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi.

- a) **Lidhur me trajtimin e paligjshëm dhe të padrejtë të pretenduar nga ankuesi, përsa i takon transferimit të tij dhe largimit nga puna.**

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie pune me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Gjirokastrës nga data 01.08.2010 deri në datën 15.8.2018, datë në të cilën i është dhënë masa disiplinore "Largim nga puna".

Rezulton e provuar se, në fillim të marrëdhënieve të punës me DRSSH Gjirokastrës ankuesi ka punuar në detyrën e Specialistit të Kontrollit të Pagesave në Degën e Financës. Me Urdhërin me

⁴ Referuar "Njoftimit për seancë dëgjimore" me nr.1174/3 prot., datë 07.10.2019, të Komisionerit.

⁵ Referuar Autorizimit me datë 28.10.2019, të Drejtorit të DRSSH Gjirokastrës.

⁶ nik-ëhay@yahoo.com

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

nr.1610 prot., datë 14.06.2018 K. L është transferuar në Degën e Kontributeve në pozicionin e Specialistit të Vetëpunësuar në Bujqësi, pozicion të cilin ai e ka pranuar, meqenëse nuk i cënohej elementi pagë. (Paga mujore ishte 53.060 lekë)

Me Urdhërin me nr.2149 prot., datë 31.07.2018 subjekti ankues është komanduar për një periudhë 3 mujore në pozicionin e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër. Për këtë pozicion pune paga mujore ishte 24.000 lekë.

Nëpërmjet shkresës me nr.2157 prot., datë 31.07.2018 ankuesi ka paraqitur një kërkesë drejtuar institucionit dhe ka kërkuar të njihet me arsyet e ndryshimit të vendit të punës, si dhe ka bërë me dije se ai nuk e pranon këtë pozicion pune, pasi e konsideron ulje në detyrë.

Duke mos marrë asnjë përgjigje nga ana e institucionit, ankuesi tre ditë pas këtij komandimi, nëpërmjet postës elektronike, me e-mail, ka vënë në dijeni edhe Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH, lidhur me mosdakordësinë e tij për këtë komandim.

Pas këtij momenti, DRSSH Gjirokastër ka evidentuar mungesën në vendin e punës të K. L (në pozicionin e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër), për periudhën nga data 1-6 gusht 2018, pra 5 (pesë) ditë.

Nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk është marrë në konsideratë mosdhënia e pëlqimit të ankuesit lidhur me detyrën e re, por nëpërmjet Urdhërit nr.2226 prot., datë 08.08.2018, për mosparaqitje në vendin e punës për 5 (pesë) ditë rresht, ka urdhëruar kalimin në një detyrë të një kategorie më të ulët për një periudhë një vjeçare.

Subjekti ankues, me t'u njohur me këtë vendim ka paraqitur ankimimin e tij në Drejtorinë Juridike, Kryetarit të KD dhe Drejtorit të Përgjithshëm, duke parashtruar se është paraqitur çdo ditë në punë, por jo në pozicionin e ri të punës, atë të Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër; por në pozicionin e mëparshëm si "Specialist i të Vetëpunësuarve në Bujqësi"

Sërisht, z.L nuk është paraqitur në punë në detyrën e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH, për 12 ditë të tjera.

Me datë 15.08.2018 është mbledhur Komisioni Disiplinor (KD) i DRSSH Gjirokastër⁷ për të shqyrtuar situatën dhe veprimet e Inspektorit të Bujkut, K. L, i cili i ka rekomanduar drejtorit të DRSSH për z.L, masën disiplinore: "Largim nga puna". Nëpërmjet Urdhërit nr.2262 prot., datë 15.08.2018, K. L, i komanduar në detyrën e Inspektorit të Bujkut në ALSSH Gjirokastër, për thyerje të rënda të disiplinës në punë dhe mosparaqitje në punë për 12 ditë rresht, i është dhënë masa disiplinore "Largim nga puna".

Duke mos rënë dakord me Vendimin për largimin e tij nga puna, subjekti ankues e ka kundërshtuar gjyqësisht atë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me Vendimin nr.827/21-2018-2137, datë 27.12.2018 ka vendosur konstatimin e zgjidhjes së kundërligjshme të kontratës së punës, lidhur mes K. L dhe DRSSH Gjirokastër. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e

⁷ Referuar procesverbalit me nr.2261 prot., datë 15.08.2018.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Apelit Gjirokastër, nëpërmjet Vendimit me nr.20-2019-294/134, datë 04.04.2019 dhe është i formës së prerë.

Komisioneri vlerëson se, megjithëse DRSSH Gjirokastër ka patur dijeni që ankuesi ka refuzuar të pranojë pozicionin/detyrën e re, atë të Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër dhe ia ka bërë të ditur shkresërisht këtë fakt, sërisht DRSSH Gjirokastër ka vijuar të argumentojë dhe dokumentojë largimin e tij nga puna, me arsyen e mosprezencës së tij në vendin e punës.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri vlerëson se kalimi/komandimi i ankuesit nga “Specialist i të Vetëpunësuarve në Bujqësi” në pozicionin e të Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër; është në fakt ndërprerje e kontratës të punës, pasi kanë ndryshuar elementët thelbësore të saj.

Në kontekst të sa mësipër, Komisioneri nuk do marrë në konsideratë komandimin/transferimin e ankuesit krahasuar me punonjësit e tjerë të DRSSH Gjirokastër, pasi në vetvehte komandimi/transferimi i tij është zgjidhje e njëanshme e kontratës së tij të punës.

Komandimi i tij ka sjellë si pasojë edhe ndryshimin e kushteve të kontratës të punës në dëm të tij, në mënyrë të njëanëshme, çka në fakt është dhe zgjidhje e saj. Njëherësh me ndryshimin e pozicionit dhe vendit të punës, është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe një element thelbësor i kontratës, siç është paga.

Lidhur me ndryshimin e elementit page, rezulton e dokumentuar se subjekti ankues, në pozicionin e Specialistit të Vetëpunësuar në Bujqësi, përfitonte pagën mujore në masën 53.060 lekë (bruto) dhe neto 43.196 lekë, ndërsa në pozicionin e Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër, përfitonte pagën në masën 24 000 lekë në muaj, pra paga mujore pothuajse i përgjysmohej në këtë rast.

Komisioneri vlerëson se, vetë Urdhëri nr.2149 prot., datë 31.07.2018, për komandimin në një detyrë tjetër të ankuesit, edhe pse për një periudhë të caktuar kohore, është në fakt zgjidhje e kontratës së punës me z.L, përse kohë ai nuk ka dhënë pëlqimin për të punuar në këtë detyrë të re. Me anën e këtij urdhëri është krijuar një marrëdhënie e re pune mes të dy palëve, e cila do të duhej të rregullohej përmes një kontrate të re pune, sipas prashikimeve të nenit 21, të Kodit të punës: “Kontrata e punës mund të lidhet dhe të ndryshohet me gojë se me shkrim. Ajo mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje midis palëve. Çdo ndryshim i kontratës së shkruar në dëm të punëmarrësit, duhet të përfundohet me shkrim”.

Neni 110, pika 1 e Kodit të Punës, përcakton se: “Punëdhënësi i paguan punëmarrësit pagën sipas dispozitave të kontratës kolektive ose kontratës individuale...”.

Pra, sikurse shihet, çdo ndryshim i kushteve thelbësore të kontratës pa miratimin e punëmarrësit do të konsiderohet zgjidhje e kontratës në mënyrë të njëanshme. Në këtë kontekst, transferimi/komandimi i K. L në një detyrë tjetër që për më tepër paguhej pothuajse sa gjysma e pagës që kishte në pozicionin e mëparshëm, përbën ndryshim të kontratës së punës në dëm të tij si

punëmarrës, dhe nuk është i vlefshëm për sa kohë ai nuk ka rënë dakord me të. Përkundrazi, rezulton e provuar dhe dokumentuar se ankuesi e ka kundërshtuar atë shkresërisht.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”.*

Kodi i Procedurës Administrative⁸ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar⁹, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/subjektit ndaj të cilit paraqitet ankesa, në këtë rast DRSSH Gjirokastër, e cila duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Referuar barrës së provës sikurse është cituar dhe më lart në vendim, DRSSH Gjirokastër, si subjekt nga i cili është pretenduar diskriminimi, duhet të provonte se ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të paligjshme, për shkakun e pretenduar prej tij.

Të provosh një çështje diskriminimi është e vështirë, pasi autorët e diskriminimit nuk deklarojnë se ata trajtojnë dikë në mënyrë më pak të favorshme se të tjerët, lidhur me një shkak të caktuar.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *“praesumptio iuris tantum”*.

⁸Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

⁹Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur i pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “ të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht”.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjinin faktin se komandimi i ankuesit nga “Specialist i të Vetëpunësuarve në Bujqësi” në pozicionin e të Inspektorit të Vetëpunësuar në Bujqësi në ALSSH Gjirokastër; të kishte ardhur për arsye të ligjshme apo të ishte i arsyeshëm dhe i justifikuar.

DRSSH Gjirokastër jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm, por shpjegimet e dhëna prej saj, janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të paligjshëm dhe të padrejtë nga ana e DRSSH Gjirokastër.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁰, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe

¹⁰ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të *“bindjeve politike”*, Komisioneri gjykon se *“bindjet politike”* konsiderohen si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Subjekti ankues, nëpërmjet Vërtetimit të lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratikë të Shqipërisë, Dega Gjirokastrë, me datë 12.07.2019. ka provuar anëtarësinë dhe angazhimin e tij politik pranë kësaj partie. Në Vërtetimin lëshuar nga Partia Demokratike/Dega Gjirokastrë, citohet se K. L është anëtarësuar pranë kësaj partie që nga viti 2009 e aktualisht.

Ankuesi është larguar nga detyra, me datë 11.05.2018, me urdhër të Drejtorit të DRSSH Gjirokastrë, z.O.K. Komisioneri vlerëson se, Drejtori i DRSSH Gjirokastrë, z.O.K i ka të ekspozuara dhe të provuara bindjet e tij të majta, si përfaqësues i forcës politike/Partisë Socialiste të Gjirokastrës, bazuar në sa më poshtë citojmë:

- Rezulton e provuar se ai ka mbajtur pozicionin e nën/kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, si përfaqësues i Partisë Socialiste të Gjirokastrës, për periudhën 2010-2017. (Në 2017 është emëruar si drejtues i DRSSH Gjirokastrë)
- Në listat e publikuar të delegatëve të rinj të Kongresit të Partisë Socialiste, i cili do të mbahet në muajin Janar 2020, një ndër 8 (tetë) emrat e publikuar të kandidatëve të përzgjedhur, rezulton të jetë dhe O. K. (O.K, B.L, A.H, M.SH, L.M, S.F, SH.F Dhe L.S)
- Po ashtu, nëpërmjet fotove të ndryshme të publikuara në faqen zyrtare të Partisë Socialiste Gjirokastrë, provohet pjesëmarrja e z.O. K, në aktivitetet politike të Partisë Socialiste të Gjirokastrës. Z.O. K, shihet të jetë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme, gjatë fushatës zgjedhore të Qershorit të vitit 2017, në krah të Kryetarit të Partisë Socialiste Gjirokastrë, z.B. K dhe Kryetarit aktual të Bashkisë Gjirkastër, z.F. G.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”.*

Në kontekst të sa më sipër, ankuesi ka provuar se ka bindje politike të ndryshme nga Drejtori i DRSSH Gjirokastrë.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm përse i takon largimit të tij nga puna.

Nga ana e DRSSH Gjirokastrë nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjinin faktin se procedura e ndjekur për largimin e ankuesit nga puna, kishte ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹¹

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja është shprehur se:

“...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësimit të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të

¹¹ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_laë_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

mundshëm”. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës (KEDNJ)¹².

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹³ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s¹⁴ që prej adoptimit në vitin 1998 të “Deklaratës së ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos ketë ratifikuar Konventat Themelore që parashtrojnë këto kritere.

Karta Sociale Europiane¹⁵ parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht”*.

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Karte do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seksi, gjuhë, besimi fetar,*

¹² “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në të për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹³ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹⁴ International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

¹⁵ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

Adresa: Rruga e Durrësit, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al

mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”.

Kodi i Punes, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁶. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10 221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10 221/2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk u arrit të provohej një përligjje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankuesit, lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të. Argumentimi i saj se largimi nga puna ka ardhur si rezultat i mosprezencës së tij në punë, rezulton i pa bazuar në prova, i padrejtë, i paligjshëm dhe për më tepër i qëllimshëm.

Në kushtet kur, nga ana e DRSSH Gjirokastër nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj tij ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja;

Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 dhe 54/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 17, të Kodit të Procedurës Administrative, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

- 1.** Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, K. L, për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë.
- 2.** Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Bindjet politike